

Banka e Shqipërisë

# TENDENCAT NË KREDITIM

*Erjona Suljoti, Medvin Shehu, Anjeza Gazidede dhe Sofika Note  
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë*

JANAR 2022

*Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*



# P Ë R M B A J T J E

<i>Hyrje</i>	4
<i>Përmbledhje</i>	5
<i>1. Kredia për biznese</i>	6
<i>2. Kredia për individë</i>	10
<i>3. Tendencat e kreditimit në vendet e rajonit</i>	13

## HYRJE

*Ky material synon të japë një panoramë të prirjes së aktivitetit kreditues në vend. Për të përmbushur këtë qëllim, në të analizohen të dhënat monetare, si dhe kushtet e kreditimit, bazuar në Vrojtimin e Aktivitetit Kreditues. Pjesë e këtij materiali është edhe një përmbledhje e zhvillimeve të fundit të aktivitetit kreditues në disa nga vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore (EQJL).*

*Statistikat kryesore të analizuar në material janë: a) të dhënat për aktivitetin kreditues të bankave për sektorin privat të ekonomisë; b) të dhënat cilësore të marra nga Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues (VAK); c) statistikat për normat e interesit të kredisë, si në monedhën vendase ashtu edhe në euro; d) të dhënat monetare për vëllimin e kredisë për vendet e rajonit. Vendet e përfshira në analizë janë: Bullgaria (BU), Kroacia (CR), Rumania (Ro), Serbia (Sr), Polonia (Pl), Hungaria (Hu), Republika Çeke (CZ), Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV).*

*Të dhënat e kredisë merren nga bilanci të bankave dhe i referohen financimit të bankave vendase për sektorin privat rezident - bizneseve dhe individëve. Analiza e portofolit të kredisë bazohet në të dhënat e kredisë të rregulluara për efektin e kursit të këmbimit dhe për kreditë e fshira nga bilanci, proces të cilin bankat e kanë ndërmarrë bazuar në vendimin nr. 50, datë 30.3.2015, "Për ndryshimin e rregullores për administrimin e rrezikut të kredisë".*

*Materiali mbulon të dhënat e disponueshme deri më 22 janar 2022, të cilat përshijnë të dhënat monetare dhe financiare në vend, deri në muajin dhjetor 2021, dhe të dhënat e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e katërt të vitit 2021. Të dhënat e kredisë për vendet e rajonit janë deri në muajin nëntor 2021.*

## PËRMBLEDHJE

Zhvillimet në portofolin e kredisë për sektorin privat në tremujorin e katërt të vitit 2021, tregojnë se:


- *Kredia për biznese ka shfaqur përmirësim të ritmeve të rritjes, duke reflektuar si rritjen e kërkesës për kredi ashtu edhe të ofertës. Të dhënat tregojnë se biznesi i madh dhe i mesëm janë përfituesit kryesorë të financimit të bankave, ndërkohë shpërndarja sektoriale e portofolit evidenton sektorët e tregtisë, turizmit dhe ndërtimit si sektorët më të kredituar.*
- *Kredia për individë është rritur më tej gjatë tremujorit të katërt të vitit. Kjo rritje si dhe me parë ka qenë e përqendruar në kredi me afat të gjatë maturimi, e cila ndikohet drejtpërdrejt nga kërkesa e lartë e individëve për kredi hipotekare. Kjo kërkesë është shoqëruar edhe me kushte favorizuese nga bankat, të cilat e kanë mbështetur financimin me maturitet afatgjatë si nëpërmjet normave të ulëta të interesit ashtu dhe lehtësimit të kushteve joçmim.*
- *Bankat kanë lehtësuar kushtet e kreditimit si për bizneset ashtu edhe për individët në tremujorin e katërt të vitit. Kjo ecuri vjen në reflektim të përmirësimit të situatës makro, të reduktimit të primeve të rrezikut, si edhe një përqsasje më pozitive ndaj kreditimit.*
- *Normat e interesit për kreditë e reja në lekë në tremujorin e fundit kanë vijuar të shfaqen të qëndrueshme. Interesat e kredive janë luhatur në nivele të ulëta, të mbështetura nga klima pozitive, politika monetare lehtësuese dhe kushte të përgjithshme favorizuese për investimet dhe konsumin. Ambienti monetar dhe financiar është karakterizuar nga prime të përmbajtura rreziku.*
- *Kredia për sektorin privat në vendet e rajonit ka shfaqur ngadalësim në terma realë, pas rikuperimit të vërejtur në tremujorin e tretë të vitit. Ky ngadalësim i dedikohet kryesisht rritjes së inflacionit në pothuajse të gjitha vendet në tremujorin e fundit të vitit. Nëse do të përjashtonim këtë efekt, kredia do të shfaqte rritje të qëndrueshme në pjesën më të madhe të vendeve. Vendet e Ballkanit vijojnë të kenë një performancë më të mirë të kredisë krahasuar me vendet e Evropës Qendrore, si për bizneset, ashtu edhe për individët.*

## 1. KREDIA PËR BIZNESE

Kredia për biznese ka shfaqur përmirësim të ritmeve të rritjes, e mbështetur nga zgjerimi i kreditimit për biznesin e mesëm dhe atë të madh. Sipas shpërndarjes sektoriale vihet re se sektori i tregtisë, i turizmit dhe i ndërtimit janë sektorët që kanë përfituar më shumë nga financimi i sektorit bankar. Këto zhvillime janë në përgjigje si të kërkesës së shtuar për financim ashtu edhe përfaqesjes më pozitive të bankave ndaj këtyre segmenteve.

Kredia për biznese ka shënuar një rritje vjetore prej 9.1% në tremujorin e katërt, duke ndjekur trajektoren pozitive të zgjerimit të kredisë në pjesën e dytë të vitit. Rritja e saj është mbështetur nga rritja e kredisë për biznesin e mesëm dhe atë të madh, e cila shënoi një rritje vjetore rreth 11%, ose rreth 2 pp më të lartë se nivelet e nëntëmujorit. Përmirësimet e ritmeve të rritjes së këtyre dy segmenteve kanë kompensuar tkurrjen e kredisë për segmentin mikron (me 14% vmv), dhe ngadalësimin e normave të rritjes së financimit të biznesit të vogël (në 7.6%). Rigjallërimi i kërkesës për kredi nga bizneset dhe përfaqesja më pozitive e bankave për rritjen e financimit të bizneseve të konsoliduara mendohet se kanë mbështetur këtë ecuri.


Portofoli i kredisë për biznese vijon të dominohet nga kreditimi i biznesit të madh. Gjatë vitit 2021, pesha e tij ndaj totalit mbeti pothuajse e pandryshuar nga një vit më parë, në 52%. Paralelisht është vënë re rritja e peshës së biznesit të mesëm në 26.7% ose 1.5 pp më shumë se një vit më parë. Ndërkohë, portofoli i kredisë për mikro-bizneset dhe biznesin e vogël është reduktuar në 21.3% të totalit, ose 2 pp më pak së një vit më parë. Në harkun kohor të 5 viteve vëmë re se mbështetja e bankave ndaj biznesit privat ka ardhur në rritje të vazhdueshme për biznesin e madh dhe të mesëm, të cilat janë biznese më të konsoliduara, të formalizuara dhe me një rritje të qëndrueshme të kërkesës për financim dhe lehtësim të kushteve të ofertës.



Shpërndarja sektoriale e portofolit të kredisë në fund të vitit 2021, tregon se bankat kanë rritur financimin për bizneset në sektorët e tregtisë, turizmit dhe të ndërtimit, dhe kanë tkurrur ekspozimin në sektorin e shërbimeve të tjera. Kështu, rritja e kredisë për bizneset në sektorët e tregtisë, turizmit dhe të ndërtimit respektivisht me 10%, 33% dhe 13% mesatarisht gjatë vitit, ka reflektuar përmirësimin e shpejtë të aktivitetit ekonomik të këtyre sektorëve si dhe përjasjen më pozitive të bankave. Në fund të vitit, kredia për këta sektorë përbën përkatësisht 37.8%, 7.8% dhe 15.8% të totalit të kredisë për biznese. Ndërkohë, kredia për bizneset në sektorin e industrisë ka shfaqur një rritje modeste prej 7%. Pësha e këtij sektori ka mbetur e pandryshuar në 25% në dy vitet e fundit. Megjithatë, në gjashtëmuorin e dytë të vitit është vënë re një rritje e financimit të bankave për bizneset që veprojnë në sektorin e energjetikës. Pësha e këtij segmenti shënoi rritje në 8.4% të kredisë për biznese, përkundrejt 7.2% që ishte në fund të gjashtëmuorit të parë.

Normat e interesit të kredive në lekë për bizneset në tremujorin e fundit të vitit kanë mbetur në nivele të ulëta. Përtej luhatshmërisë që i karakterizon, interesat e kredisë edhe në muajt e fundit kanë reflektuar përjasjen pozitive të bankave ndaj financimit të sektorit privat. Kushtet e pandryshuara monetare edhe një ambient i qetë financiar kanë favorizuar bankat në këtë drejtim. Ecuri të njëjtë kanë treguar edhe interesat e kredive në euro, ndryshimet e të cilave kanë qenë marginale dhe niveli i tyre ka rezultuar afër vlerave të tremujorëve të mëparshëm.


Në tremujorin e katërt, normat e interesit të kredisë për bizneset kanë qëndruar në nivele të afërta me tremujorin e tretë. Norma mesatare e interesit për këtë segment rezultoi 5.7%, nga 5.6% që ishte në tremujorin paraardhës dhe ndaj mesatares së vitit. Përtej luhatjeve mujore, interesat e aplikuara nga bankat evidentojnë prime të qëndrueshme rreziku dhe përjasje pozitive të bankave ndaj ekonomisë. Analiza sipas segmenteve tregon një rritje të lehtë të interesave tek segmenti i kredive deri në 35 mln lekë. Norma mesatare e kësaj kategorie rezultoi 5.9% nga 5.7% që ishte mesatarisht në dy tremujorët



paraardhës. Vlera e këtij tremujori reflekton kryesisht rritjen e interesave për këtë segment në muajin tetor dhe është më së shumti e lidhur me peshën edhe interesin e regjistruar nga një bankë e caktuar. Interesat për kreditë në segmentin mbi 35 mln lekë, ndërkohë, nuk kanë ndryshuar këtë tremujor, duke qëndruar në 5.5%.

Analiza sipas periudhës së fiksimit fillestar të normës së interesit tregon një rritje të lehtë të normës afatshkurtër të interesit (e ndryshueshme ose e fiksuar për vitin e parë të kredisë) këtë tremujor. Kjo normë ka rezultuar në rritje që prej tremujorit të dytë të këtij viti. Gjithsesi, interesi i kësaj kategorie (5.7%) mbetet shumë pranë mesatares së gjysmës së parë të këtij viti (5.6%) edhe e vitit të kaluar (5.7%).

Norma e interesit e kategorisë që përfron periudhën afatmesme apo afatgjatë (normë interesi e fiksuar mbi një vit) nuk ndryshoi këtë tremujor, duke rezultuar 5.6% nga 5.7% që ishte në pjesën e parë të vitit. Ecuria e interesave tek të dyja këto kategori konfirmon pritje të përmbajtura inflacioni nga ana e agjentëve financiarë dhe rrezik minimal të perceptuar prej tyre në këtë periudhë.




Interesi i kredisë në euro i bizneseve regjistroi një rritje të lehtë këtë tremujor, duke rezultuar 4.6% nga 4.4% që ishte një tremujor më parë. Gjithsesi, niveli mesatar i interesave të kredisë në euro gjatë këtij viti ka qenë bindshëm poshtë vlerave të vitit të kaluar. Sipas madhësisë së kredisë, interesat kanë shënuar rritje marginale tek kreditë e vogla (deri në 250 mijë euro) edhe tek kreditë e mëdha (mbi 1 mln euro), ndërkohë që segmenti i mesëm nuk ka ndryshuar. Analiza sipas periudhës së fiksimit të normës së interesit, këtë tremujor evidentohen rritjen minimale të interesit, si tek kreditë me normë interesi të fiksuar deri në një vit ashtu edhe tek kreditë me normë të fiksuar mbi një vit.

Kushtet joçmim janë lehtësuar për bizneset, duke konfirmuar një përjasje më pozitive të bankave ndaj financimit të tyre.



Kushtet e ofertës së kredisë për bizneset vijuan përmirësimin edhe në tremujorin e katërt të vitit 2021, duke ndjekur linjë të ngjashme me rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik dhe treguesve të besimit. Politikat më të relaksuara të kreditimit kundrejt bizneseve janë shprehur në lehtësim të standardeve, kushteve e termave të kreditimit. Për herë të parë pas tre viteve, bankat lehtësuan dhe kushtet e termat e kreditimit për bizneset, duke iu ofruar lehtësira si në komponentë çmim – nëpërmjet uljes së marzheve për kreditë normale – ashtu edhe në ato joçmim – duke ulur komisionet mbi kreditë e disbursuara. Lehtësimi i kushteve të ofertës për kredi ka qenë më i dukshëm në kreditë e miratuara për biznesin e madh, për të dytin tremujor me radhë, duke akomoduar në të njëjtën kohë një kërkesë të shtuar për kredi, veçanërisht nga ky segment. Përmirësimi i dykahshëm i treguesve të kreditimit – ofertë dhe kërkesë për kredi – mbështetet në përmirësimin e tablosë makroekonomike e financiare në vend, e cila i ka shërbyer në të njëjtën kohë vlerësimeve më optimiste të treguesve të lidhur me rrezikun e kredisë.

Grafik 4. Kushtet joçmim për kreditë e reja të bizneseve




Për informacion më të detajuar, lutemi referojuni rubrikës mbi vërtetimin e aktivitetit kreditues në lidhjen:  
[https://www.bankofalbania.org/Politika\\_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi\\_i\\_aktivitetit\\_kreditues/](https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/).  
 Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të stafit.

## 2. KREDIA PËR INDIVIDË

Kredia për individë është rritur më tej gjatë tremujorit të katërt të vitit. Kjo rritje si dhe me parë ka qenë e përqendruar në kredinë me afat të gjatë maturimi, e cila ndikohet drejtpërdrejt nga kërkesa e lartë e individëve për kredi hipotekare. Kjo kërkesë është shoqëruar edhe me kushte favorizuese nga bankat, të cilat e kanë mbështetur financimin me maturitet afatgjatë si nëpërmjet normave të ulëta të interesit ashtu dhe lehtësimit të kushteve joçmim.


Kredia për individë është zgjeruar me ritme të larta rritjeje me mesatarisht 11.4% në tremujorin e fundit, përkundrejt 10.5%, mesatares së vitit deri në muajin shtator. Kjo rritje ka reflektuar përmirësimin e mëtejshëm të kredisë me afat të gjatë maturimi mbi një vit, e cila ka kompensuar edhe për tkurrjen e kredisë afatshkurtër. Ritmet e larta të rritjes së kredisë me afat të mesëm dhe të gjatë maturimi - 14% përkundrejt mesatares prej 11% në nëntë muajt e parë të vitit - reflekton kërkesat për financim e blerjeve të banesave dhe të mallrave të konsumit afatgjatë.




Zgjerimi i vazhdueshëm i portofolit të kredisë për individë në segmentin afatgjatë është reflektuar edhe në rritjen e peshës së tij në 84% në fund të vitit 2021. Rritja e saj ka reflektuar si rritjen e qëndrueshme të kredisë hipotekare dhe mjedisin me norma të ulëta të interesit dhe kushtet joçmim favorizuese.

Norma e interesit e kredisë për individët këtë tremujor nuk ka ndryshuar për kreditë në lekë, ndërsa është rritur lehtës për ato në euro. Gjithsesi, interesat e kredisë gjenden më poshtë se mesatarja e një viti më parë për të dyja monedhat. Individët kanë përfituar norma më të ulëta të interesit për kreditë konsumatore, ndërkohë që normat e interesit për kreditë hipotekare kanë regjistruar rritje minimale për të dyja monedhat.

Norma mesatare e interesit për kreditë hipotekare në lekë për individët u rrit lehtas në tremujorin e fundit, duke shënuar 3.6% nga 3.2% që ishte një tremujor më parë. Duke përjashtuar tremujorin e parë, kjo normë luhatet poshtë nivelit 4.0% këtë vit. Rritja e interesave të kësaj kategorie këtë tremujor ka reflektuar kryesisht rritjen e tyre tek kreditë me normë të fiksuar deri në 1 vit, ndërkohë që kategoria me interesa të fiksuara deri 5- ose 10-vjet ka regjistruar vlera afërsisht të njëjta me tremujorin e mëparshëm. Interesat e kredisë konsumatorë janë ulur lehtas këtë tremujor, duke konfirmuar një ambient mbështetës për kërkesën e individëve këtë periudhë. Interesi i kësaj kategorie rezultoi 7.9% në këtë tremujor, duke regjistruar një ulje prej 0.4 pp nga tremujori i kaluar, si dhe nga gjysma e parë të vitit.




Norma mesatare e kredive në euro për individë shënoi një rritje të lehtë në tremujorin e fundit të vitit, duke rezultuar 3.9% nga 3.6% dhe 3.4% që ishte respektivisht në dy tremujorët paraardhës. Ecuria e lehtë rritëse këtë tremujor ka reflektuar kryesisht rritjen e tyre tek kategoria e kredive për blerje banese. Gjithsesi, përgjatë këtij viti, interesat e kredisë në euro janë luhatur dukshëm poshtë niveleve të vitit 2020 (4.1%). Ashtu si në kredinë në lekë, edhe interesat e kredisë në euro për individë këtë tremujor u rritën lehtas për kredinë hipotekare, ndërkohë që u ulën për kredinë konsumatore. Brenda kategorisë së kredisë për shtëpi, interesat janë rritur si për kredinë me normë të fiksuar deri një vit ashtu edhe për atë me fiksime norme interesi mbi një vit. Diferenca midis interesit të kredisë hipotekare në lekë dhe asaj në euro në këto muaj vijon të jetë minimale.



Kushtet dhe termat e kreditimit në kreditë e reja akorduar individëve u lehtësuan më tej.

Bankat preferuan të lehtësonin kushtet e ofertës edhe për individët, kryesisht në kreditë hipotekare. Standardet e kreditimit në këtë segment u lehtësuan. Po ashtu, bankat miratuan edhe një numër më të lartë kërkesash për kredi gjatë tremujorit të katërt të vitit. Ndërkohë, kushtet e termat e përgjithshëm të kreditimit për individët në tërësi nuk ndryshuan, pas lehtësimit të vijuar gjatë pesë tremujorëve të mëparshëm. Nga elementet joçmim, bankat preferuan të lehtësonin kushtet e përgjithshme nëpërmjet shtimit të madhësisë së kredisë, çka u neutralizua nga kërkesat e shtuara për kolateral dhe nga maturiteti më i ulët i kredisë.




### 3. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT<sup>1</sup>

Në muajt tetor dhe nëntor, kredia për sektorin privat në vendet e rajonit ka shfaqur ngadalësim në terma realë, pas rikuperimit të vërejtur në tremujorin e tretë të vitit. Ky ngadalësim i dedikohet kryesisht rritjes së inflacionit në pothuajse të gjitha vendet në tremujorin e fundit të vitit. Vendet e Ballkanit vijojnë të kenë një performancë më të mirë të kredisë krahasuar me vendet e Evropës Qendrore, si për bizneset, ashtu edhe për individët.

Kredia për sektorin privat në vendet e rajonit të EQJL-së u rrit vjetore e saj shënoi mesatarisht me 0.5% gjatë muajve tetor dhe nëntor, nga 1.5% në tremujorin e tretë të vitit. Ngadalësimi në terma realë reflekton kryesisht efektin e rritjes së inflacionit në të gjitha vendet në muajt e fundit të vitit të kaluar.<sup>2</sup> Në mungesë të këtij faktori, kredia do të shfaqte rritje të qëndrueshme apo edhe përmirësim gradual me tremujorin e tretë në shumicën e vendeve.

Në vendet e Ballkanit, kredia është rritur me një normë vjetore prej 3.2% në këta dy muaj, kurse në vendet e Evropës Qendrore, rritja është e papërfillshme. Shqipëria ka shfaqur një performancë më të mirë ndër vendet e Ballkanit, e tejkuluar vetëm nga Rumania në segmentin e bizneseve. Vrojtimi i aktiviteti kreditues (VAK) për vendet e rajoni, realizuar nga Banka Evropiane e Investimeve, evidenton një rritje të kërkesës për kredi dhe lehtësim të kushteve të kreditimit për tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2021. Pritjet janë për vijimësi të këtyre trendeve deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2022.



<sup>1</sup> Në këtë analizë përfshihen 9 vende të rajonit të Evropës Qendrore dhe Juglindore: Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Kroaci, Serbi, Bullgari, Rumania, Republikë Çeke, Poloni dhe Hungari. Stoku i kredisë për sektorin privat është i rregulluar për efektin e inflacionit dhe kursit të këmbimit.

<sup>2</sup> Zhveshja e kredisë nga efekti i kursit të këmbimit dhe deflatimi i saj me indeksin e çmimeve të konsumit janë të nevojshme për një krahasim të saktë të performancës mes vendeve. Rritja e inflacionit është një ndër faktorët që ka ndikuar ngadalësimin e përgjithshëm të kredisë në muajt tetor dhe nëntor krahasuar me tremujorin e tretë të vitit.


Kredia për biznese në rajon vazhdon të shfaqë ecuri të ndryshme në vendet e Ballkanit krahasuar me ato të Evropës Qendrore. Në grupin e këtyre të fundit, kredia për biznese vijon të tkurret, duke reflektuar rënien e portofolit në Poloni e në Republikën Çeke. Tkurrja e saj rezultoi 2.9% gjatë muajve tetor dhe nëntor, nga 2.6% që shënonte mesatarisht në tremujorin e tretë të vitit. Megjithatë, rënia e portofolit të kredisë në pjesën e dytë të vitit paraqitet më e përmbajtur në krahasim me pjesën e parë të tij, ku portofoli u tkurr me një normë vjetore mesatare prej 4.8%. Ndryshe nga vendet e sipërpërmendura, Hungaria paraqet një moment pozitiv sa i takon ecurisë së kredisë për biznese. Në vendet e Ballkanit, kredia për biznese ka vazhduar të rritet, por me një ritëm më të ulët se në tremujorin e tretë të vitit. Rritja vjetore shënoi mesatarisht 3.8% në muajt tetor dhe nëntor, nga 5.1% që ishte në tremujorin e mëparshëm. Vendet me performancën më të mirë renditen Rumania dhe Shqipëria, ndërkohë që kredia për biznese në vendet e tjera është tkurrur ka ngadalësuar normat e rritjes.



Sipas VAK-ut për vendet e rajonit, kërkesa për kredi nga ana e bizneseve është rritur, duke reflektuar rritjen e kërkesës për financim të investimeve, krahas rritjes së mëtejshme të kërkesës për kapital qarkullues. Rritja e kërkesës ka ardhur si nga bizneset e mëdha, ashtu edhe nga ato të mesme e të vogla, dhe është nxitur nga rimëkëmbja ekonomike. Në vazhdim, kërkesa nga bizneset pritet të rritet më tej, me një kontribut të fortë nga kërkesa për financim të investimeve.

Kredia për individë është ngadalësuar në terma realë në muajt tetor dhe nëntor, në të gjitha vendet e marra në analizë. Ajo shënoi një rritje mesatare vjetore prej 1.6% gjatë këtyre dy muajve, nga 2.8% që ishte në tremujorin e tretë të vitit. Zgjerimi i kredisë për individë vazhdon të udhëhiqet gjithashtu nga vendet e Ballkanit. Kërkesa për kredi nga individët vlerësohet e rritur, si për kredi hipotekare, ashtu edhe për kreditë konsumatore, e nxitur nga përmirësimi i besimit konsumator dhe prospekti i mirë i tregut të banesave. Kjo tendencë pritet të vijojë edhe në tremujorin e parë të këtij viti.

Grafik 11. Kredia për individët në rajonin e EQJL-së



Burimi: Banka e Shqipërisë; bankat e vendeve të rajonit; BEI - Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues në vendet e EQJL-së; llogaritje të stafit.

